

VENDIM
Nr. 576, datë 13.10.2017

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DISA ANËTARËVE TË KËSHILLIT
TË STATISTIKAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004, “Për statistikën zyrtare”, të ndryshuar, dhe në vijim të shkronjave “c” e “ç”, të pikës 14, të vendimit nr. 999, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e përfaqësimit, përzgjedhjes, të emërimit e të shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lirimin nga detyra e anëtarit të Këshillit të Statistikave, në përputhje me përcaktimet e shkronjave “c” dhe “ç”, të pikës 14, të vendimit nr. 999, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave, të:

- a) Znj. Ilda Malile, përfaqësues i përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare;
- b) Z. Dhimitër Tole, përfaqësues i botës akademike;
- c) Znj. Mirela Muça, përfaqësues i shoqërisë civile.

2. Emërimin në detyrën e anëtarit të Këshillit të Statistikave të:

- a) Z. Adrian Kamenica, përfaqësues i përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare;
- b) Znj. Kozeta Sevrani, përfaqësues i botës akademike;
- c) Z. Engjëll Skreli, përfaqësues i shoqërisë civile.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama